



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nr.1895/5 prot.

Datë 07.08.2026

V E N D I M
Nr. 948/2026

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Ismail Shehu	Kryetar
Edvin Simo	Anëta
Nertil Kanina	Anëtar

Në mbledhjen e datës 07.08.2026 u shqyrtua ankesa me

Objekt: Urdhër për pezullimin e shqyrtimit administrativ të ankimit elektronik, me nr. A/2026/6810, datë 15.06.2026, protokolluar me nr.1895/2026 prot, datë 16.06.2026, të operatorit ekonomik “PC Store” SHPK, për procedurën e prokurimit “*E hapur, e thjeshtuar*”, me nr. REF-84163-05-04-2026, me objekt: “*Ndërtimi dhe mirëmbajtje e faqes zyrtare të ALPEX për dy vite*”, me fond limit 1,500,000 lekë pa TVSH, zhvilluar me datë 18-05-2026 nga autoriteti kontraktor, “Bursa Shqiptare e Energjisë Elektrike” – ALPEX SHA.

Subjekte të Interesuar: “Bursa Shqiptare e Energjisë Elektrike” – ALPEX SHA, me adresë: Rruga Liman Kaba, Rezidenca Olympic, Shkalla 3, Kati 1, Zyra nr.1, Tiranë

Operatori ekonomik “PC Store” SHPK me NUIS L01606034A dhe adresë: Rruga e Dibrës, vila 153, kati 1, Tiranë.

Operatori ekonomik “LACONICS” SHPK me NUIS M02325002F dhe adresë: Rruga “Hoxha Tahsim”, aktualisht Rruga Manol Konomi, Zona Kadastrale 8150, Pasuria Nr.2/543+1-37,Tiranë

Baza Ligjore:

Nenet 30 dhe 115 të ligjit nr. 162/2020 *“Për Prokurimin Publik”*, i ndryshuar; Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 *“Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”*, i ndryshuar, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766/2021, datë 13.10.2021 *“Për miratimin e rregullave “Për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”*”.

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi dëgjoi relatorin e çështjes, shqyrtoi parashtimet me shkrim e pretendimet e ankimuesit, dhe pasi diskutoi çështjen në tërësi,

Vëren:**I**

I.1. Në datën 05.05.2026, është publikuar në Sistemin e Prokurimeve Elektronike, procedura e prokurimit *“E hapur, e thjeshtuar”*, me nr. REF-84163-05-04-2026, me objekt: *“Ndërtimi dhe mirëmbajtje e faqes zyrtare të ALPEX për dy vite”*, me fond limit 1,500,000 lekë pa TVSH, zhvilluar me datë 18-05-2026 nga autoriteti kontraktor, “Bursa Shqiptare e Energjisë Elektrike” – ALPEX SHA.

I.2. Në datën 26.05.2026 autoriteti kontraktor ka përfunduar fazën e vlerësimit të ofertave. Ofertuesit janë njoftuar elektronikisht si vijon:

1. “Laconics” SHPK	850.000 lekë, kualifikuar
2. “PC Store” SHPK	888.800 lekë, kualifikuar
3. “Soft & Solution” SHPK	913.579 lekë, kualifikuar
4. “Instant.AI” SHPK	984.000 lekë, kualifikuar
5. “Idealdens Corporation” SHPK	1.000.900 lekë, kualifikuar
6. Evolve Ëeb Studio” SHPK	1.050.000 lekë, kualifikuar

I.3. Në datën 08.06.2026 autoriteti kontraktor ka publikuar njoftimin e fituesit të procedurës së prokurimit në SPE.

I.4. Në datën 15.06.2026, nëpërmjet Sistemit të Ankesave Elektronike pranë Komisionit të Prokurimit Publik, është administruar ankimi elektronik, me nr. A/2026/6810, protokolluar me nr.1895/2026 prot, datë 16.06.2026, i operatorit ekonomik “PC Store” SHPK, për procedurën e prokurimit *“E hapur, e thjeshtuar”*, me nr. REF-84163-05-04-2026, me objekt: *“Ndërtimi dhe mirëmbajtje e faqes zyrtare të ALPEX për dy vite”*, me fond limit 1,500,000 lekë pa TVSH,

zhvilluar me datë 18-05-2026 nga autoriteti kontraktor, “Bursa Shqiptare e Energjisë Elektrike” – ALPEX SHA.

Nga shqyrtimi paraprak i ankesës të sipërcituar, u konstatua se objekti i ankesës lidhet me vendimmarrjen e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave mbi kualifikimin e ofertës të paraqitur nga operatori ekonomik “LACONICS” SHPK në procedurën e mësipërme të prokurimit.

I.5. Në përputhje me nenin 112 “Veprimet paraprake” të Ligjit nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik”, me marrjen e ankesës, Komisioni i Prokurimit Publik e publikoi atë në bazën e të dhënave të tij, e cila përmban të dhëna për: a) ankimuesin, adresën dhe NUIS-in; b) të dhëna të plota për procedurën e prokurimit (objekt, numër reference, fond limit, datën e zhvillimit të procedurës), si dhe është publikuar formulari i publikimit Nr. 1895/1 Prot., datë 17.06.2026.

I.6. Në datën 22.06.2026 është protokolluar në Komsionin e Prokurimit Publik me nr.1895/2 prot., shkresa e autoritetit kontraktor nr.148/19 prot., datë 22.06.2026 me objekt: “*Informacion lidhur me procedurën e prokurimit mr REF-84163-05-04-2026*”. Referuar kësaj shkrese rezulton ankesa nuk është marrë në shqyrtim nga ana e autoritetit kontraktor, me arsyetimin se është depozituar pas përfundimit të afatit ligjor të ankimit, të parashikuar në nenin 110 të LPP-së. Konkretisht është argumentuar nga AK si më poshte vijon:

“[...]Për procedurën e mësipërme ju informojmë në mënyrë kronologjike si në vijim. Kjo procedurë është publikuar në sistemin elektronik të prokurimit publik në datën 05.05.2026. Afati për paraqitjen e ofertave ka përfunduar në datën 18.05.2026, ora 10:00, moment në të cilin është kryer edhe hapja e ofertave të paraqitura nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurë. Pas përfundimit të procesit të shqyrtimit dhe vlerësimit të ofertave, në përputhje me kriteret e përcaktuara në dokumentet e tenderit dhe dispozitat e Ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Komisioni Vlerësimit të Ofertave ka bërë klasifikimin e ofertave të operatorëve ekonomikë pjesëmarrës dhe në datën 08.06.2026 është publikuar në sistemin elektronik të prokurimit publik, Njoftimi Paraprak i Fituesit, ku rezulton se është shpallur fitues operatori ekonomik “LACONICS”, me NIPT M02325002F, me ofertën më të ulët ekonomike, në vlerën prej 850,000.00 (tetëqind e pesëdhjetë mijë) lekë pa TVSH.

Referuar nenit 110 të Ligjit Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, të ndryshuar, operatorët ekonomikë kanë të drejtë të ushtrojnë ankim kundër vendimeve të Autoritetit Kontraktor brenda afateve të përcaktuara nga ligji. Për procedurat e prokurimit nën kufijtë e lartë monetar, ankesa kundër vendimit të klasifikimit përfundimtar paraqitet brenda 7 (shtatë) ditëve nga publikimi i njoftimit përkatës në sistemin elektronik të prokurimit publik. Për rrjedhojë, me publikimin e Njoftimit Paraprak të Fituesit në datën 08.06.2026 ka filluar edhe afati ligjor i ushtrimit të së drejtës së ankimit nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurë. Gjithashtu me ndryshimin e Ligjit Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, nëpërmjet Ligjit Nr.16/2024 “Për disa shtesa dhe ndryshime në Ligjin Nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik”, në Nenin 110 është shtuar dhe pika 9

e cila sqaron se: “Sistemi i prokurimit elektronik njofton operatorët ekonomikë në mënyrë automatike për datën e fillimit dhe të përfundimit të afateve të ankimit”.

Në vijim, Autoriteti Kontraktor ka monitoruar në mënyrë të vazhdueshme sistemin elektronik të ankesave për të verifikuar paraqitjen e mundshme të ankesave lidhur me këtë procedurë prokurimi. Më datë 15.06.2026, në orën 13:17, në sistemin elektronik të prokurimit publik jemi njoftuar se afati i ankimit për këtë procedurë prokurimi ka përfunduar dhe duke qenë se deri në këtë moment në sistemin elektronik të ankesave nuk ishte paraqitur ndonjë ankesë lidhur me këtë procedurë prokurimi, kemi proceduar me hapat e mëtejshëm që është Njoftimi Përfundimtar i Fituesit.

Vetëm për kronologji të fakteve përmendim që Autoriteti Kontraktor ka publikuar më datë 15.06.2026, në orën 13:28, Njoftimin Përfundimtar të Fituesit për operatorin ekonomik “LACONICS”, me NIPT M02325002F, dhe Agjencia e Prokurimit Publik e ka publikuar në datën 16.06.2026, ora 12:34.

Nga verifikimi i të dhënave rezulton se operatori ekonomik “PC STORE” shpk, ka depozituar një ankesë online për këtë procedurë prokurimi me numër Reference REF-84163-05-04 2026, në datën 15.06.2026, ora 17:00:15. Kjo ankesë është protokolluar nga Komisioni Prokurimit Publik në datën 16.06.2026 me Nr. Protokolli 1895/2026 dhe publikuar më datë 17.06.2026.

Sa më sipër, Autoriteti Kontraktor vlerëson se ankesa rezulton e depozituar pas përfundimit të afatit ligjor të ankimit të parashikuar në nenin 110 të ligjit Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar. Ky vlerësim mbështetet në kronologjinë e veprimeve të kryera në sistemet elektronike. Autoriteti Kontraktor paraqet këtë informacion për dijeni dhe vlerësim nga ana e Komisionit të Prokurimit Publik, duke bashkëlidhur dokumentacionin përkatës të gjeneruar nga sistemi elektronik i prokurimit publik, ku pasqyrohen datat dhe orët e veprimeve procedurale të kryera.”

II

Komisioni i Prokurimit Publik

pas shqyrtimit të ankesës, dokumentacionit bashkëngjitur saj, si dhe informacionit e dokumentacionit të paraqitur nga ana e autoritetit kontraktor,

Arsyeton

II.1. Në datën 05.05.2026, është publikuar në Sistemin e Prokurimeve Elektronike, procedura e prokurimit “E hapur, e thjeshtuar”, me nr. REF-84163-05-04-2026, me objekt: “Ndërtimi dhe mirëmbajtje e faqes zyrtare të ALPEX për dy vite”, me fond limit 1,500,000 lekë pa TVSH, zhvilluar me datë 18-05-2026 nga autoriteti kontraktor, “Bursa Shqiptare e Energjisë Elektrike” – ALPEX SHA.

II.2. Në datën 26.05.2026 autoriteti kontraktor ka përfunduar fazën e vlerësimit të ofertave. Ofertuesit janë njoftuar elektronikisht si vijon:

1. “Laconics” SHPK	850.000 lekë, kualifikuar
2. “PC Store” SHPK	888.800 lekë, kualifikuar
3. “Soft & Solution” SHPK	913.579 lekë, kualifikuar
4. “Instant.AI” SHPK	984.000 lekë, kualifikuar
5. “Idealdens Corporation” SHPK	1.000.900 lekë, kualifikuar
6. Evolve Eëb Studio” SHPK	1.050.000 lekë, kualifikuar

II.3. Në datën 08.06.2026 autoriteti kontraktor ka publikuar njoftimin e fituesit të procedurës së prokurimit në SPE.

II.4. Në datën 15.06.2026, nëpërmjet Sistemit të Ankesave Elektronike pranë Komisionit të Prokurimit Publik, është administruar ankimi elektronik, me nr. A/2026/6810, protokolluar me nr.1895/2026 prot, datë 16.06.2026, i operatorit ekonomik “PC Store” SHPK, për procedurën e prokurimit “E hapur, e thjeshtuar”, me nr. REF-84163-05-04-2026, me objekt: “Ndërtimi dhe mirëmbajtje e faqes zyrtare të ALPEX për dy vite”, me fond limit 1,500,000 lekë pa TVSH, zhvilluar me datë 18-05-2026 nga autoriteti kontraktor, “Bursa Shqiptare e Energjisë Elektrike” – ALPEX SHA.

Nga shqyrtimi paraprak i ankesës të sipërcituar, u konstatua se objekti i ankesës lidhet me vendimmarrjen e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave mbi kualifikimin e ofertës të paraqitur nga operatori ekonomik “LACONICS” SHPK në procedurën e mësipërme të prokurimit.

II.5. Në përputhje me nenin 112 “Veprimet paraprake” të Ligjit nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik”, me marrjen e ankesës, Komisioni i Prokurimit Publik e publikoi atë në bazën e të dhënave të tij, e cila përmban të dhëna për: a) ankimuesin, adresën dhe NUIS-in; b) të dhëna të plota për procedurën e prokurimit (objekt, numër reference, fond limit, datën e zhvillimit të procedurës), si dhe është publikuar formulari i publikimit Nr. 1895/1 Prot., datë 17.06.2026.

II.6. Në datën 22.06.2026 është protokolluar në Komisionin e Prokurimit Publik me nr.1895/2 prot., shkresa e autoritetit kontraktor nr.148/19 prot., datë 22.06.2026 me objekt: “Informacion lidhur me procedurën e prokurimit mr REF-84163-05-04-2026”. Referuar kësaj shkrese rezulton ankesa nuk është marrë në shqyrtim nga ana e autoritetit kontraktor, me arsyetimin se është depozituar pas përfundimit të afatit ligjor të ankimimit, të parashikuar në nenin 110 të LPP-së. Konkretisht është argumentuar nga AK si më poshte vijon:

“[...]Për procedurën e mësipërme ju informojmë në mënyrë kronologjike si në vijim. Kjo procedurë është publikuar në sistemin elektronik të prokurimit publik në datën 05.05.2026. Afati për paraqitjen e ofertave ka përfunduar në datën 18.05.2026, ora 10:00, moment në të cilin është kryer edhe hapja e ofertave të paraqitura nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurë. Pas përfundimit të procesit të shqyrtimit dhe vlerësimit të ofertave, në përputhje me kriteret e përcaktuara në dokumentet e tenderit dhe dispozitat e Ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin

Publik”, Komisioni Vlerësimit të Ofertave ka bërë klasifikimin e ofertave të operatorëve ekonomikë pjesëmarrës dhe në datën 08.06.2026 është publikuar në sistemin elektronik të prokurimit publik, Njoftimi Paraprak i Fituesit, ku rezulton se është shpallur fitues operatori ekonomik “LACONICS”, me NIPT M02325002F, me ofertën më të ulët ekonomike, në vlerën prej 850,000.00 (tetëqind e pesëdhjetë mijë) lekë pa TVSH.

Referuar nenit 110 të Ligjit Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, të ndryshuar, operatorët ekonomikë kanë të drejtë të ushtrojnë ankim kundër vendimeve të Autoritetit Kontraktor brenda afateve të përcaktuara nga ligji. Për procedurat e prokurimit nën kufijtë e lartë monetar, ankesa kundër vendimit të klasifikimit përfundimtar paraqitet brenda 7 (shtatë) ditëve nga publikimi i njoftimit përkatës në sistemin elektronik të prokurimit publik. Për rrjedhojë, me publikimin e Njoftimit Paraprak të Fituesit në datën 08.06.2026 ka filluar edhe afati ligjor i ushtrimit të së drejtës së ankimit nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurë. Gjithashtu me ndryshimin e Ligjit Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, nëpërmjet Ligjit Nr.16/2024 “Për disa shtesa dhe ndryshime në Ligjin Nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik”, në Nenin 110 është shtuar dhe pika 9 e cila sqaron se: “Sistemi i prokurimit elektronik njofton operatorët ekonomikë në mënyrë automatike për datën e fillimit dhe të përfundimit të afateve të ankimit”.

Në vijim, Autoriteti Kontraktor ka monitoruar në mënyrë të vazhdueshme sistemin elektronik të ankesave për të verifikuar paraqitjen e mundshme të ankesave lidhur me këtë procedurë prokurimi. Më datë 15.06.2026, në orën 13:17, në sistemin elektronik të prokurimit publik jemi njoftuar se afati i ankimit për këtë procedurë prokurimi ka përfunduar dhe duke qenë se deri në këtë moment në sistemin elektronik të ankesave nuk ishte paraqitur ndonjë ankesë lidhur me këtë procedurë prokurimi, kemi proceduar me hapat e mëtejshëm që është Njoftimi Përfundimtar i Fituesit.

Vetëm për kronologji të fakteve përmendim që Autoriteti Kontraktor ka publikuar më datë 15.06.2026, në orën 13:28, Njoftimin Përfundimtar të Fituesit për operatorin ekonomik “LACONICS”, me NIPT M02325002F, dhe Agjencia e Prokurimit Publik e ka publikuar në datën 16.06.2026, ora 12:34.

Nga verifikimi i të dhënave rezulton se operatori ekonomik “PC STORE” shpk, ka depozituar një ankesë online për këtë procedurë prokurimi me numër Reference REF-84163-05-04 2026, në datën 15.06.2026, ora 17:00:15. Kjo ankesë është protokolluar nga Komisioni Prokurimit Publik në datën 16.06.2026 me Nr. Protokolli 1895/2026 dhe publikuar më datë 17.06.2026.

Sa më sipër, Autoriteti Kontraktor vlerëson se ankesa rezulton e depozituar pas përfundimit të afatit ligjor të ankimit të parashikuar në nenin 110 të ligjit Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar. Ky vlerësim mbështetet në kronologjinë e veprimeve të kryera në sistemet elektronike. Autoriteti Kontraktor paraqet këtë informacion për dijeni dhe vlerësim nga ana e Komisionit të Prokurimit Publik, duke bashkëlidhur dokumentacionin përkatës të gjeneruar nga sistemi elektronik i prokurimit publik, ku pasqyrohen datat dhe orët e veprimeve procedurale të kryera.”

II.5. Neni 24, pika 1, “Komisioni i Prokurimit Publik” i ligjit 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, parashikon shprehimisht se:

“Komisioni i Prokurimit Publik është organi më i lartë administrativ në fushën e prokurimeve, që shqyrton ankesat për procedurat e prokurimit dhe kryen çdo detyrë tjetër që i ngarkohet me këtë ligj dhe akte të tjera ligjore brenda fushës së kompetencave të tij”.

II.6. Neni 30, pika 1, “Veprimtaria e Komisionit të Prokurimit Publik” i ligjit 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, parashikon shprehimisht se:

“Komisioni i Prokurimit Publik shqyrton ankesat e paraqitura para tij kur në mbledhje janë të pranishëm të paktën 3 nga 5 anëtarët e tij, një prej të cilëve kryetari ose nënkryetari. Në përfundim të shqyrtimit të ankesave, Komisioni vendos me shumicë votash. Vendimi deklarativ i dhënë sipas parashikimeve të nenit 115, pikat 2 dhe 3, të këtij ligji, jepet nga 3 anëtarë për procedurat e prokurimit nën kufirin e ulët monetar dhe nga 5 anëtarët për procedurat e tjera. Shqyrtimi i ankesave për procedurat e prokurimit nën kufirin e ulët monetar do të bëhet nga 3 anëtarë të Komisionit të Prokurimit Publik”.

II.7. Në nenin 110, pikat 2, 7 dhe 8 “Afatet për ankimim” të Ligjit 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, parashikohet shprehimisht se:

“2. Në procedurat e prokurimit mbi kufirin e lartë monetar, në rastin e ankesave për vendimin e vlerësimit/klasifikimit përfundimtar, operatorët ekonomikë kanë të drejtë të ankohen brenda 10 ditëve nga publikimi i njoftimit të fituesit ose publikimi i njoftimi të anulimit.

Në procedurat e prokurimit nën kufirin e lartë monetar ky afat është 7 ditë.

7. Në rast se operatori ekonomik nuk paraqet ankesën brenda afateve të parashikuara në këtë nen, atëherë nuk ka mundësi të ushtrojë më të drejtën e ankimit pranë autoritetit ose entit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik.

8. Të shtunat, të dielat dhe ditët e festave zyrtare nuk pengojnë fillimin dhe kohëzgjatjen e afateve. Kur dita e fundit e një afati bie e shtunë, e diel ose një ditë feste zyrtare, afati mbaron në ditën e punës që vjen pas saj. Ankesa quhet e pranuar në ditën e depozitimit të saj pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik.”.

II.8. Në nenin 111, pika 1, të Ligjit 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, parashikohet shprehimisht se: *“1. Operatori ekonomik ankimes dërgon njëkohësisht ankesën në autoritetin ose entin kontraktor dhe Komisionin e Prokurimit Publik në Sistemin e Ankesave Elektronike. Rregulla të posaçme për mënyrën e paraqitjes së ankesës përcaktohen në rregullat e prokurimit publik.”.*

II.9. Neni 112, pikat 1 dhe 2 të Ligjit 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, parashikon shprehimisht se:

“1. Me regjistrimin e ankesës në Sistemin e Ankesave Elektronike dhe publikimin e saj nga Komisioni i Prokurimit Publik, Sistemi i Prokurimit Elektronik në ndërveprim me Sistemin e Ankesave Elektronike pezullon në mënyrë automatike vazhdimin e procedurës së prokurimit deri në shqyrtimin plotësisht të ankesës, përfshirë edhe nxjerrjen e një vendimi nga Komisioni i

Prokurimit Publik me nënshkrim dhe vulë elektronike. Sistemi duhet të zhvillohet duke përdorur teknologji të avancuara të inteligjencës artificiale dhe procese të robotizuara për të kryer pezullimin dhe nxjerrjen nga pezullimi automatik i procedurave të prokurimit.

2. Komisioni i Prokurimit Publik, me marrjen e ankesës në përputhje me këtë ligj, publikon në bazën e të dhënave përmes ndërveprimit me sisteme të treta, të dhënat e mëposhtme: a) për ankimuesin, adresën dhe NUIS-in; b) të dhëna të plota për procedurën e prokurimit (objekt, numër reference, fond limit, datën e zhvillimit të procedurës).

II.10. Në nenin 97 “Afatet për paraqitjen e ankesave”, të VKM-së nr 766/2021, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave “Për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, i ndryshuar, është parashikuar shprehimisht si vijon:

1. Në rastin e ankesave për dokumentet e tenderit, operatorët ekonomikë mund të ankohen pranë autoritetit/entit kontraktor:

a) brenda 10 (dhjetë) ditëve nga publikimi i njoftimit të kontratës, ose publikimi i ndryshimit të kërkesave në dokumentet e tenderit në procedurat e prokurimit mbi kufirin e lartë monetar;

b) brenda 7 (shtatë) ditëve nga publikimi i njoftimit të kontratës, ose publikimi i ndryshimit të kërkesave në dokumentet e tenderit në procedurat e prokurimit nën kufirin e lartë monetar.

2. Në rastin e ankesave për vendimin e vlerësimit/klasifikimit përfundimtar, operatorët ekonomikë mund të ankohen pranë autoritetit/entit kontraktor:

a) brenda 10 (dhjetë) ditëve nga publikimi i njoftimit të fituesit, ose publikimi i njoftimit të anulimit, në procedurat e prokurimit mbi kufirin e lartë monetar;

b) brenda 7 (shtatë) ditëve nga publikimi i njoftimit të fituesit, ose publikimi i njoftimit të anulimit, në procedurat e prokurimit nën kufirin e lartë monetar.

3. Në rastin e ankesave për vendimin e përzgjedhjes së kandidatëve pas fazës së parakualifikimit, në procedurat e prokurimit me faza, operatorët ekonomikë mund të ankohen pranë autoritetit/entit kontraktor:

a) brenda 10 (dhjetë) ditëve nga marrja e njoftimit për këtë vendim, në procedurat e prokurimit mbi kufirin e lartë monetar;

b) brenda 7 (shtatë) ditëve nga marrja e njoftimit për këtë vendim, në procedurat e prokurimit nën kufirin e lartë monetar.

4. Në rastin e ankesave për lidhjen e një kontrate në bazë të një marrëveshjeje kuadër, me disa operatorë ekonomikë, pas procedurave për rihapjen e konkurrimit, operatorët ekonomikë mund të ankohen pranë autoritetit/entit kontraktor:

a) brenda 10 (dhjetë) ditëve nga data e publikimit të njoftimit të fituesit të kontratës, në procedurat e prokurimit mbi kufirin e lartë monetar;

b) brenda 7 (shtatë) ditëve nga data e publikimit të njoftimit të fituesit të kontratës, në procedurat e prokurimit nën kufirin e lartë monetar.

5. Në llogaritjen e afateve për paraqitjen e ankesës sipas përcaktimeve në këtë nen nuk do të përfshihet dita e publikimit të njoftimeve përkatëse.

II.11. Referuar bazës ligjore të sipërcituar Komisioni i Prokurimit Publik gjykon, se afati për dorëzimin e ankesës pranë Komisionit të Prokurimit Publik dhe autoritetit kontraktor, në procedurat e prokurimit nën kufirin e lartë monetar, në rastin e ankesave për vendimin e vlerësimit/klasifikimit përfundimtar, është brenda 7 (shtatë) ditëve nga publikimi i njoftimit të fituesit, ose publikimi i njoftimit të anulimit. Në rastin konkret, afati i fundit për paraqitjen e ankesës në autoritetin ose entin kontraktor dhe në Komisionin e Prokurimit Publik, referuar datës së publikimit të njoftimit të fituesit dt. 08.06.2026, ka qenë brenda 7 ditëve, nga data e nesërme e publikimit të njoftimit të fituesit. Në këtë kuadër, ankesa pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik është paraqitur në datë 15.06.2026, pra brenda afateve ligjore të ankimimit.

Sa më sipër, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon, se referuar nenit 111, pika 1 të ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, operatori ekonomik ankimues dërgon njëkohësisht ankesën në autoritetin ose entin kontraktor dhe Komisionin e Prokurimit Publik në Sistemin e Ankesave Elektronike. Në rastin konkret, ankesa e operatorit ekonomik ankimues, rezulton, se është dorëzuar brenda afateve ligjore të përcaktuara në nenin 110, pika 2 e LPP i cili parashikon, se “Në procedurat e prokurimit mbi kufirin e lartë monetar, në rastin e ankesave për vendimin e vlerësimit/klasifikimit përfundimtar, operatorët ekonomikë kanë të drejtë të ankohen brenda 10 ditëve nga publikimi i njoftimit të fituesit ose publikimi i njoftimit të anulimit. Në procedurat e prokurimit nën kufirin e lartë monetar ky afat është 7 ditë”.

Sa më sipër arsyetuar, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon, se ankesa e dorëzuar nga operatori ekonomik ankimues, ka përmbushur detyrimin për ndjekjen e afateve ligjore të ankimimit në autoritet kontraktor dhe në Komisionin e Prokurimit Publik, ndaj nuk përbën shkak për mospranimin e ankesës nga ana e autoritetit kontraktor. Komisioni i Prokurimit Publik rithekson bindjen e tij, se për shkak të specifikës së prokurimeve publike, respektimi i afateve, është i një rëndësie thelbësore e me ndikim të drejtpërdrejtë në efikasitetin e procedurës, ndaj edhe i qëndron strikt rregullit të parashikuar nga ligji i prokurimit publik si *lex specialis* mbi lëndën.

Për sa më sipër, në mbështetje të neneve 30, dhe 118 të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 236, datë 20.04.2023, “Për përcaktimin e rregullave dhe tarifës së pagesës për ankimin në një procedurë prokurimi pranë Komisionit të Prokurimit Publik”, Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766,

datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri,

Vendos:

1. Autoriteti kontraktor të marrë në shqyrtim ankesën e paraqitur nga operatori ekonomik “PC Store” SHPK, për procedurën e prokurimit “E hapur, e thjeshtuar”, me nr. REF-84163-05-04-2026, me objekt: “Ndërtimi dhe mirëmbajtje e faqes zyrtare të ALPEX për dy vite”, me fond limit 1,500,000 lekë pa TVSH, zhvilluar me datë 18-05-2026 nga autoriteti kontraktor “Bursa Shqiptare e Energjisë Elektrike” – ALPEX SHA.
2. Autoriteti kontraktor të dërgojë menjëherë pranë Komisionit të Prokurimit Publik informacion të hollësishëm mbi zhvillimin e procedurës së mësipërme të prokurimit, ku të pasqyrohet procesi i shqyrtimit dhe vlerësimit të ofertave; të jepen argumentimet përkatëse mbi pretendimet e operatorit ekonomik “PC Store” sh.p.k; si dhe të jepet informacion i hollësishëm, vërtetuar me dokumentacion për trajtimin e ankesës.
3. I gjithë informacioni dhe dokumentacioni i kërkuar, të paraqitet jo më vonë se 5 ditë nga data e marrjes së këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Anëtar
Edvin Simo

Anëtar
Nertil Kanina

Kryetar
Ismail Shehu

